



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Roskovec, më 02/06/2020

Nr. 2415 prot.

VENDIM

NR 38. DATË 29.05.2020

“PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA E URBANISTIKËS TË FERMERËVE QË DO TË NDËRTOJNË URË AUTO TIP PËR KALIM MBI KANALET KULLUES”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 gërma f dhe k; ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar neni 41, të VKM-së Nr.408 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar neni 7, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.105 datë 22.11.2019 “Per miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020” pika 7 e Kreut II.11, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Përrjashtimin nga tarifa e urbanistikës, për fermerët që do të ndërtojnë urë-auto për kalim mbi kanalet kulluese K-34 Suk 2-Kolektor, K-26 Jagodinë-Suk, për aplikimin si më poshtë:
 - a) Deklaratë paraprake për kryerje punimesh me objekt shërbimi
- 2- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

